

# Plagoset Vali Corleone, arrestohet një femër 22 vjeçare



11/08/2022 09:53

f

🐦

🔗

Të shtëna me armë zjarri raportohet të ketë pasur në orët e para të mëngjesit në Gjiilan.

Si pasojë e këtyre të shtënave i plagosur ka mbetur qytetari gjilanas, i njohur si Vali Corleone.

Në njoftimin e Policisë së Kosovës theksohet se nga hetimet e para në vendin e ngjarjes e dyshuar në lidhje me këtë rast është një grua, shtetase e Kosovës rreth moshës 22 vjeçare , e cila dyshohet se e ka shkrepur armën.

Rasti është konfirmuar për Lajmi.net edhe nga Zyra për Informim e Policisë së Kosovës në Gjiilan.

Tutje u tha se nga ky rast është konfiskuar edhe një armë pistoletë dhe 40 fishekë të së njëjtës armë.

Për rastin është njoftuar edhe Prokurori i Shtetit, i cili ka urdhëruar që të ngritet Kallëzim Penal për “Vrasje në tentativë” dhe e dyshuara të ndalet në mbajtje për 48 orë, teksa Policia e Kosovës është duke hetuar rrethanat e incidentit.

## Njoftimi i plotë:

Drejtoria Rajonale Gjilan, Stacioni Policor Gjilan në orët e hershme të mëngjesit nga Qendra Emergjente Rajonale Gjilan është informuar se aty ishte sjellur një person i lënduar si pasoj e gjuajtjes me armë zjarri.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitet relevante. Sipas raportit të mjekut viktimë P.C. (1983) Shqiptar, shtetas i Kosovës është jashtë rrezikut për jetë.

Nga hetimet e para në vendin e ngjarjes mësohet se e dyshuar në lidhje me rastin është një femër Shqiptare shtetase e Kosovës viti i lindjes (2000), e cila dyshohet se ka shkrepur nga arma.

Për momentin nuk dihen motivet e incidentit.

Një armë Pistoletë dhe dyzet (40) copë fishekë të të njëjtës armë janë konfiskuar në vendin e ngjarjes si prova materiale për Gjykatë.

Për rastin është njoftuar Prokurori i Shtetit i cili ka urdhëruar që të ngritet Kallëzim Penal për „Vrasje në tentativë” dhe e dyshuara të ndalet në mbajtje për 48 orë , gjersa Policia e Kosovës, Njësi i Hetimeve Rajonale Gjilan janë duke i hetuar rrethanat e incidentit./Lajmi.net/




## Artikuj të ngjashëm



August 11, 2022  
BE nën presion për të ndaluar hyrjen e turistëve rusë në Europë



August 11, 2022  
VV: Tenderi 12 milionë euro i shpallur nga Përparim Rama i...



August 11, 2022  
Një i vdekur dhe 780 raste të reja me COVID-19 në Kosovë



August 11, 2022  
Gjohitet ngasësi pasi ngiste automjetin 106 km/h aty ku lejohet vetëm...



August 11, 2022  
“Përshkallëzimi i situatës në veri në konflikt të armatosur”, nga BE...



August 11, 2022  
Zhduket Ervis Martinaj, familjarët thonë se kanë humbur kontaktet me të

LAJME TË FUNDIT

BE nën presion për të ndaluar hyrjen e turistëve rusë në Europë

Promtori i Furyt tregon për një meç të mundshëm Fury – Joshua

Një i vdekur dhe 780 raste të reja me COVID-19 në Kosovë

“Përshkallëzimi i situatës në veri në konflikt të...

## Other Links